



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11 dhe 13 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, nenit 23.3 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.04/2023 Për Administratë të Hapur në Komunë dhe nenet 14, 16 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr.prot.01-020/01-0050862/18, merr;

VENDIM PËR VËNIE NË KONSULTIM PUBLIK

Neni 1

Vëhet në konsultim publik:

➤ **Draft Programi Trevjeçar i Banimit 2026-2028**

Neni 2

Diskutimi publik sipas këtij paragrafi, zgjat 30 ditë përkatësisht prej datës, **24.02.2026 deri më 24.03.2026**, brenda së cilës Grupi Punues për hartimin e **Draft Programit Trevjeçar të Banimit 2026-2028**, mund të organizoj diskutime/konsultime të ndryshme publike, kurse Debati i përgjithshëm publik me qytetarë mbahet më **11.03.2026**, duke filluar nga ora **10:00**, në ndërtesën e re të Komunës, kati përdhës - salla e mbledhjeve.

Neni 3

Propozimet, sugjerimet, apo vërejtjet eventuale paraqiten gjatë debateve publike, gjithashtu në formë të shkruar mund të paraqiten gjatë kohëzgjatjes së diskutimit/konsultimit publik në Zyrën për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim, ndërtesa e re e Komunës zyra nr.54, si dhe në formë elektronike mund të dërgohen në e-mail adresën; **arbresha.bashota@rks-gov.net** të cilat pastaj përcjellën në Zyrën përkatëse, brenda periudhës së diskutimit/konsultimit publik.

Neni 4

Dokumenti sipas nenit 1, është pjesë përbërëse e këtij vendimi dhe i njëjti publikohet në ueb-faqen zyrtare të Komunës: **http://kk.rks-gov.net/podujeve** (rubrika; **aktet për diskutim publik**) dhe në lokalitete të ndryshme aty ku Komuna e vlerëson të nevojshme.

Neni 5

Konsultimi/debati publik zbatohet nga Grupi Punues për hartimin e **Draft Programit Trevjeçar të Banimit 2026-2028**, në bashkëpunim dhe koordinim me Zyrën për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim, që përkujdeset për përgatitjen e raportit nga konsultimi dhe debati publik dhe të jap sqarime për arsyeshmërinë e pranimi ose mospranimi të propozimeve dhe sugjerimeve konkrete.

Neni 6

Pas shqyrtimit dhe miratimit, Vendimi hyn në fuqi pas 7 ditë pas publikimit ueb faqen zyrtare të Komunës.

Nr.prot. 02-016/01-0011237/26
Podujevë, datë: 24.02.2026

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi